



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 992/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “Alb Tech” Sh.p.k, me nr.unik identifikues 811183376 dhe me seli në Gjilan, rr. “Rruga e Muhaxherëve” p.n., që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat A.H. nga Gjilani, kundër debitorit AL PLAST uPVC Sh.P.K., me nr. unik identifikues 811303023, me seli në Gjilan, rr. “Lufta e Gjilanit” nr.44, p.nr., që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat I.Z. me zyre në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 228/23 të datës 29.05.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Sefer Sh. Arifi me seli në Gjilan, jashtë seancës, me datë 10.01.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit AL PLAST uPVC Sh.P.K., ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 228/23 i datës 29.05.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Sefer Sh. Arifi, MBETET NË FUQI.
- II. OBLIGOHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, t’ia paguaj kreditorit shumën prej EUR 104.00 (me shkronja: njëqind e katër euro), në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Alb Tech” Sh.P.K., me datë 29.05.2023 ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.228/23 duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve: faturë nr. 13-1754 të datës 06.10.2022, faturë nr. 13-1756 të datës 06.10.2022, faturë nr. 13-1761 të datës 07.10.2022, faturë nr. 13-1762 të datës 07.10.2022, faturë nr. 13-1774 të datës 0086.10.2022 dhe faturë nr. 13-1791 të datës 11.10.2012, ashtu që është detyruar debitori AL PLAST uPVC Sh.P.K., që në emër të pjesës së borxhit të papaguar nga faturat e lartcekura, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 4,570.46 EUR (me shkronja: katërmijë e pesëqind

e shtatëdhjetë euro e katër dhjetë e gjashtë euro cent) me kamatë ligjore prej 8 %, në vit, sipas LMD-së si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përbarimor duke theksuar se kreditori i ka bashkangjitur propozimit për përbarim edhe faturën nr. 13-1754 të datës 06.10.2022 në vlerë prej 1,753.86 EUR e cila nuk përbën detyrim për debitorin, kjo pasi që porosinë sipas kësaj fature debitori e ka kthyer mbrapa, për shkak të mos përmbushjes së porosisë ashtu siç është kërkuar prej kreditorit, fakt ky që vërtetohet nga komunikimet elektronike të zhvilluara me kreditorin, e rrjedhimisht kemi të bëjmë me konstatim të gabuar të gjendjes faktike. Ka shtuar se debitori ka paguar pjesën më të madhe të detyrimit, përkatësisht ka paguar vlerën prej 10,000.00 EUR, por që Përbaruesi Privat gabimisht ka lejuar përbarimin edhe për faturën nr. 13-1754 të datës 06.10.2022. Me kërkesë që prapësimi i debitorit të aprovohet ndërsa urdhri për lejimin e përbarimit të anulohet.

Kreditori në përgjigje ndaj prapësimit i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit me arsyetimin se sipas komunikimit elektronik të datës 23.12.2022 të cilës i referohet debitori, kreditori i ka kthyer email-in duke ia bashkangjitur kartelën financiare për vitin 2022, në të cilën kartelë ka qenë e përfshirë edhe fatura nr. 13-1754 e datës 06.10.2022, ndërsa në komunikimin të cilën i referohet debitori, askund nuk ceket se është kontestuar fatura e lartcekur. Tutje ka shtuar se edhe në komunikimin elektronik të datës 19.01.2023, debitori përsëri ka kërkuar fatura për kthim të mallit, por pa e specifikuar se cilin mall, cilën faturë e konteston apo cilën shumë e kundërshton. Në lidhje me këtë, ka shtuar se sipas nenit 293 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, kur nuk ekziston deklarata e debitorit, atëherë detyrimet përmbushën me radhë ashtu siç kanë arritur për përmbushje, ndërsa radha e përmbushjes është sikurse e përshkruar në propozimin për përbarim, ku prej shumës totale prej 14,570.46 EUR, debitori ka paguar shumën prej 10,000.00 EUR, duke ngelur në obligim në vlerë prej 4,570.46 EUR. Me kërkesë që prapësimi i debitorit të refuzohet ndërsa urdhri për lejimin e përbarimit të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, andaj u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti urdhri përmbarimor P.nr. 228/23 i datës 29.05.2023 mbështetet në faturat nr. 13-1754 të datës 06.10.2022, faturë nr. 13-1756 të datës 06.10.2022, faturë nr. 13-1761 të datës 07.10.2022, faturë nr. 13-1762 të datës 07.10.2022, faturë nr. 13-1774 të datës 0086.10.2022 dhe faturë nr. 13-1791 të datës 11.10.2012 të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkuara mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, Gjykata gjeti se faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara edhe në nenin 37 të LPP, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal, dhe të njëjtat janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi dhe vula e debitorit e vënë tek pranuesi i secilës faturë.

Gjykata pati parasysh pretendimet e ngritura nga debitori se fatura nr. 13-1754 e datës 06.10.2022 nuk është e përshtatshme për përmbarim pasi që debitori ka kthyer porosinë sipas kësaj fature meqenëse nuk ishte bërë sipas kërkesave të debitorit, por që nga komunikimet elektronike të bashkangjitura nga debitori, nuk vërtetohet se ky i fundit ka kundërshtuar shprehimisht faturën e lartcekur sipas numrit, datës dhe vlerës së saj. Në anën tjetër, me vet faktin se debitori ka pranuar faturën e lartcekur pa evidentuar asnjë vërejtje apo kundërshtim, nënkupton se i njëjti ka pranuar detyrimin që rrjedh nga kjo faturë dhe afatin e pagesës së saj.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e tjera të debitorit por gjeti se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së për t’i vërtetuar ekzistimin e një prej shkaqeve të parapara me nenin 71 të LPP-së për pranim të prapësimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbarimore, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 17 dhe 13 të LPP-së, duke ia njohur kreditorit shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në

prapësim në shumën prej 104.00 €, siç është e përcaktuar me Rregulloren e OAK-së e datës 18.03.2017 nr. tarifor gjashtë (6), lidhur me parashtrirat për përmbartimet në bazë të dokumentit të besueshëm me vlerë mbi në lartësinë e kontestit të vlerës së vogël.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 992/2023, datë 10.01.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.